



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” e konform nenit 22, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15 dhe 28, lidhur me nenin 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë ,-----
----- miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim personit fizik dhe juridik: firmës **“Immoland” SH.P.K** me seli në Prizren, Rr. “William Walker” nr.7, me person përgjegjës Blerim BAJRAKTARI me vendbanim në Rr. “Ali Hadri” A/1-23 në Prizren; **I jepet** në shfrytëzim afatgjatë deri në **99, (nëntëdhjetë e nëntë)** vite prona e paluajtshme e Komunës, parcela kadastrale **P-72116046-00545-6**, me sipërfaqe të përgjithshme prej: **S=348m²**, sipas certifikatës së pronës Nr. 1942/2025 të datës 06.05.2025, zona kadastrale Suharekë, vendin i quajtur **“Fshat”**, e evidentuar në emër të Komunës së Suharekës, për ndërtimin e objektit afarist banesor, me destinim sipas Hartës zonale të Komunës së Suharekës, banim me shumë njësi dhe afarizëm ZSHP-5, sipas rekomandimit 01-Nr-016-24991 të datës 29.04.2025, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 2

Komuna e Suharekës në këtë rast do të përfitoj 21% (njëzet e një përqind) të ndërtimit neto, banesa dhe lokale afariste në objektin i cili do të ndërtohet në parcelën e lartcekur nga investitori.

Neni 3

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme fillon të rrjedh nga data, **00.02.2026** dhe përfundon afati më datën, **00.02.2125**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik i pronës së paluajtshme të cekur më lart.

Neni 4

4.1 Obligohet: Kryetari i Komunës që me personin fizik dhe juridik përfitues i përzgjedhur për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të lidh kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

4.2. Obligohet; përfituesi i pronës të paluajtshme të Komunës, konkretisht personi fizikë i cekur në neni 1, të këtij vendimi, që në afat prej 10, (dhjetë) dite nga data e miratimit të këtij vendimi të sjellin garancionin bankar ose sigurimin nga kompanitë e sigurimeve të licencuar në Republikën e Kosovës dhe atë 10% të vlerës së propozuar investive.

4.3 Nëse personi i cekur në paragrafin 2, të nenit 3, të këtij vendimi nuk e sjellin dokumentacionin e kërkuar në afatin ligjor, konsiderohet se ka hequr dorë nga shfrytëzimi i pronës së paluajtshme.

Neni 5

5.1 Obligohen shfrytëzuesi i cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që **pronën e paluajtshme** të cekur në nenin 1, të këtij vendim, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

5.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI